



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 4 nëntor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim lidhur me Kërkesën e Haradinajt për Riklasifikimin e Pjesëve të
Transkriptit si Publike**

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Methju Haling

Valeria Boliçi

Xhejms Pejs

Mbrojtjes së Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bouden

Elenor Stivenson

Mbrojtjes së Nasim Haradinajt

Tobi Kadman

Karl Bakli

Xhonatan Pitër Uorbojs

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të nenit 40(4) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 84(1) dhe 120 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Nga 18 deri më 26 tetor 2021, Trupi Gjykues dëgjoi dëshminë e W04841-shit, dëshmitari i parë i Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS").
2. Më 24 tetor 2021, Mbrojtja e Nasim Haradinajt ("Mbrojtja") parashtroi një kërkesë që të riklasifikoheshin si publike disa pjesë të transkripteve të seancave gjyqësore që ishin mbajtur në sesione private ("Kërkesa").¹
3. Më 26 tetor 2021, ZPS-ja dha përgjigje ndaj Kërkesës ("Përgjigja").²

II. PARASHTRIME

4. Kërkesa është e dyfishtë. Së pari, Mbrojtja kërkon që Trupi Gjykues të riklasifikojë si publike pjesën e mëposhtme të pyetjeve të Mbrojtjes drejtuar W04841-shit, që është dëgjuar në seancë private ("Pjesa"):

Z. RIS: Keni thënë që nuk dini asgjë lidhur me hetimin mbi procesin se si kanë arritur dokumentet në selinë e Shoqatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së. Atëherë, çfarë do të thoshit po t'ju pyesja nëse kishit dijeni siç kishte Zyra e Prokurorit të Specializuar se ka prova se janë vjedhur dokumentet?

DESHMITARI: S'kam asnjë ide.³

¹ F00395, Mbrojtja e Haradinajt, *Parashtrime të Mbrojtjes mbi Riklasifikimin si Publik të Pjesëve të Transkripteve të Seancave Private* ("Kërkesa"), 24 tetor 2021, konfidencial. *Shih gjithashtu* F00395/RED, publik.

² F00403, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Haradinajt për Riklasifikimin e Dëshmisë së Dëgjuar në Seancë Private* ("Përgjigja"), 26 tetor 2021, konfidencial.

³ Kërkesa, paragrafët 13, 16, 24, që i referohen Transkriptit, 21 tetor 2021, f. 1249, rreshtat 4-10.

5. Së dyti, Mbrojtja i kërkon Trupit Gjykses të shqyrtojë pjesë të transkriptit që pasqyrojnë seancat private me qëllim që ato të riklasifikohen si publike ose që të nxjerrë versione publike të tyre të redaktuara, aty ku është e domosdoshme dhe e përshtatshme.⁴

6. ZPS-ja nuk kundërshton riklasifikimin e Pjesës si publike, duke deklaruar se nuk sheh arsye që ajo të mos jetë e qasshme për publikun.⁵ Për sa i përket ftesës së përgjithshme që i bëhet Trupit Gjykses që të shqyrtojë transkriptet e të gjitha seancave private, ZPS-ja parashtron se, sidoqoftë do të ishte më mirë që Mbrojtja të specifikonte se cilat pjesë të dëgjua në seancë private mendon se duhen riklasifikuar.⁶

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

7. Parimi që procedurat të jenë publike është i mishëruar në kuadrin ligjor të Dhomave të Specializuara. Sipas nenit 40(4) të Ligjit, seancat janë publike përveç se kur Paneli vendos që të jenë të mbyllura sipas Rregullores. Sipas rregullës 120 të Rregullores: (i) çdo seancë gjyqësore para një trupi gjykses, veç kuvendimeve, është publike, përveç se kur trupi gjykses vendos për të kundërtën pasi të ketë dëgjuar palët; (ii) seancat me dyer të mbyllura ose private mbahen në rrethana të veçanta dhe arsyet shqiptohen publikisht; dhe (iii) trupi gjykses mund të urdhërojë mbajtjen e seancave me dyer të mbyllura për arsye të, ndër të tjera, mosnxjerrjes së identitetit të një dëshmitari ose një viktime pjesëmarrëse në proces, ose interesave të drejtësisë.

8. Sipas rregullës 84(1) të Rregullores, trupi gjykses rishikon klasifikimin e dokumentacionit të procesit gjyqësor, dhe, kur është e zbatueshme, urdhëron riklasifikimin e tij.

⁴ Kërkesa, para. 25.

⁵ Përgjigjja, para. 1.

⁶ Përgjigjja, para. 3.

IV. DISKUTIM

9. Fillimisht, Trupi Gjykues vëren se Pjesa nuk përmban informacion konfidencial. Për rrjedhojë, nuk ka arsye që Pjesa të mbetet konfidenciale dhe Trupi Gjykues urdhëron që të riklasifikohet si publike.

10. Trupi Gjykues vëren se Mbrojtja në Kërkesën e saj ka përfshirë komente lidhur me vlerësimin e dëshmisë së W04841-shit,⁷ të cilat kundërshtohen nga ZPS-ja.⁸ Këto çështje nuk janë të lidhura me vendimin aktual.

11. Për sa i përket kërkesës së përgjithshme të Mbrojtjes për shqyrtim, Trupi Gjykues është i ndërgjegjshëm për detyrimin që ka në përgjithësi për të shqyrtuar klasifikimin e dokumentacionit të procesit gjyqësor dhe, kur është e zbatueshme, për të urdhëruar riklasifikimin e tij, sipas rregullës 84(1) të Rregullores. Kërkesat e përgjithshme të palëve në këtë aspekt janë të panevojshme. Megjithëkëtë, në rast se ndonjë palë mendon që pjesë të veçanta të dokumentacionit të procesit gjyqësor të mbajtur në seancë private duhen riklasifikuar si publike, pala mund të parashtrojë kërkesë të arsyetuar me anë të së cilës të identifikojë pjesët e veçanta të transkriptit për të cilat kërkon riklasifikim, bashkë me propozimin e versioneve të redaktuara sipas nevojës.

V. KLASIFIKIMI

12. Trupi Gjykues vëren se Mbrojtja ka dorëzuar një version publik të redaktuar të Kërkesës dhe se ZPS-ja nuk është kundër riklasifikimit të Përgjigjes.⁹ Bazuar në vendimin aktual, Trupi Gjykues i kërkon Zyrës Administrative ta riklasifikojë Përgjigjen (F00403) si publike.

⁷ Kërkesa, para. 18, 24.

⁸ Përgjigjja, para. 2.

⁹ Përgjigjja, para. 4.

VI. VENDIM

13. Për këto arsye, Trupi Gjykses:

- a. **MIRATON** kërkesën për riklasifikimin e Pjesës; dhe
- b. **URDHËRON** Zyrën Administrative që deri më **8 nëntor 2021** të riklasifikojë si publike:
 - i. Pjesën e paraqitur në paragrafin 4 të këtij vendimi në transkriptin e 21 tetorit 2021 (f. 1249, rreshtat 4-10); dhe
 - ii. Përgjigjen (F00403).

/nënshkrim/

Gjykatës Çarls L. Smith, III
Kryegjykatës

E enjte, 4 nëntor 2021

Hagë, Holandë